

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 432 Prot.

Tiranë, më 19.042016

**VENDIM Nr. 26, datë 13.04.2016**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërbimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë"(i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.4 të datës 13.04.2016, pasi shqyrtoi Relacionin mbi punimet në kuadër të *Projektit "Rehabilitimi i Manastirit të Shën Mërisë dhe peisazhit i Parkut Arkeologjik të Apolonisë, Fier"*, paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "AD-STAR" SH.P.K. dhe i verifikimit në terren nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Relacionin mbi punimet në kuadër të Projektit "Rehabilitimi i Manastirit të Shën Mërisë dhe peisazhit i Parkut Arkeologjik të Apolonisë, Fier", paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "AD-STAR" SH.P.K. dhe i verifikimit në terren nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, sipas përcaktimeve të mëposhtme.
2. Në zonën e propozuar për spostimin e depos së ujit Nr. 2, jashtë murit antik të Apolonisë, të ruhet varri monumental, të kryhet gërmimi arkeologjik i shpëtimit dhe dokumentimi i varreve të tjerë, të zbuluar në këtë zonë, në vijim të realizohet zbatimi i projektit saj. Raporti i rezultateve të gërmimit arkeologjik të paraqitet në KKA e radhës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**

**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**

**RUDINA ZOTO**